



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of
Kosovo



Komuna e
Prishtinës
Opština Priština –Municipality of
Prishtina

Drejtoria e Bujqësisë

THIRRJE PËR APLIKIM

Përkrahje në blegtori – pagesa direkte

Njoftohen të gjithë fermerët e komunës së Prishtinës, të cilët posedojnë gjedhe qumështore, si dhe kafshë të imëta - dele dhe dhi, se mund të aplikojnë për subvencione në lëmin e blegtorisë - pagesa direkte.

Kriteret që duhet t'i plotësojnë fermerët/aplikuesit:

Përkrahen fermerët që kanë:

- 3 - 10 krerë gjedhe (lopë qumështore);
- 20 -150 krerë dele;
- 20 - 150 krerë dhi;
- Kafshët duhet të jenë të matrikuara;
- Përfituesi duhet të jetë banorë i komunës së Prishtinës;
- Objekti (stalla) të jetë në territorin e komunës së Prishtinës.

Dokumentacioni i nevojshëm:

- Kopja e një dokumenti identifikues të vlefshëm të Republikës së Kosovës;
- Konfirmimi i llogarisë bankare;
- Vërtetim nga shërbimet veterinarë;
- Vërtetimi mbi tatimin në pronë për vitin 2022;
- Numri identifikues i fermerit (NIF).

Aplikimi, nga 27.02.2023 deri më 15.03.2023